

Tiranë, më 29.7.2025

Njoftim për shtyp

Kolegji i Posaçëm i Apelimit më datë 29.7.2025, ora 14.00, zhvilloi seancën gjyqësore publike të vendimin për çështjen (JR) nr. 6/2023, datë 03.02.2023, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 598, datë 13.12.2022, që lidhet me subjektin e rivlerësimit, z. Genci Mane, prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier.

Në përfundim të gjykit, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë unanime, vendosi:

Ndryshimin e vendimit nr. 598, datë 13.12.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Genci Mane.

Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 29.07.2025, në Tiranë.

Ankimi është publikuar në faqen zyrtare të SPAK-ut, në rubrikën “Procesi i rivlerësimit”:
<https://spak.gov.al/>

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, referuar nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ushtron kompetencat e Komisionerëve Publikë, që prej datës 1.1.2025.